

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE


NIPT L71710039A

Nr.2054 Regj  
Nr. 88<sup>4</sup> Prot

Tiranë, më 04.07.2023

URDHËR  
“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit ✓  
Adresa: Tirane  
Drejtuar: Shoqeria “Alesio 2014” Shpk me Nipt L41713003M  
Adresa: Rr. Lord Bajron, Njesia Bashkiake Nr.11, banese private Nr.14, Tirane  
Per djeni: Shoqeria “Albatrop Construction & Design” shpk me Nipt K82112008L  
Adresa: Rr. Faik Konica, Nd.12 prabe Universitetit Bujqesor Kamez



Unë, Eris Sotiri, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyres Përmbarimore Private “REAL BAILIFF SERVICE”, në referim të Urdherit të Ekzekutimit “Vendimi Nr.5808 Akti date 10.05.2023, i Gjykates se Shkalles se Pare Juridiksionit te Pergjithshem Tirane”, kam vënë në ekzekutim këtë Urdher, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.2054, Datë 21.06.2023 kërkesën e kreditorit Shoqeria “Albatrop Construction & Design” shpk me Nipt K82112008L ndaj debitorit Shoqeria “Alesio 2014” Shpk me Nipt L41713003M, në lidhje me titullin ekzekutiv “Fature Tatimore Nr.23 date 30.11.2021” per te cilin ka dale Urdheri i Ekzekutimit “Vendimi Nr.5808 Akti date 10.05.2023, i Gjykates se Shkalles se Pare Juridiksionit te Pergjithshem Tirane”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr.839 Prot, Datë 21.06.2023, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdheri i Ekzekutimit “Vendimi Nr.5808 Akti date 10.05.2023, i Gjykates se Shkalles se Pare Juridiksionit te Pergjithshem Tirane”, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori Shoqeria “Alesio 2014” Shpk me Nipt L41713003M, nuk i eshte pergjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit Shoqeria “Alesio 2014” Shpk me Nipt L41713003M, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, me qellim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore Shoqeria “Alesio 2014” Shpk me Nipt L41713003M, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqesor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE “REAL BAILIFF SERVICE”  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
ERIS SOTIRI

